



**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**  
**KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**  
**Drejtoria e Subjekteve Zgjedhore, Mbikëqyrjes, Financimit dhe**  
**Monitorimit**

**NJOFTIM**

**PËR TË APLIKUAR SI EKSPERT KONTABËL TË LICENSUAR (AUDITUES LIGJOR) PËR**  
**AUDITIMIN E FUSHATËS ZGJEDHORE PËR ZGJEDHJET E PJESSHME PËR KRYETAR**  
**TË BASHKISË HIMARË, TË DATË 4 GUSHT 2024**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve përmes këtij njoftimi, bën thirrje publike për shfaqje interesi për të qenë ekspert kontabël të licensuar (auditues ligjor) për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga subjektet zgjedhore dhe kandidatët e tyre për fushatë zgjedhore për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të bashkisë Himarë, të datës 4 Gusht 2024.

Ekspertët kontabël të licensuar (audituesit ligjor), përveç kushteve të përgjithshme të ushtrimit të profesionit të përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duhet të plotësojnë njëkohësisht edhe kriteret e mëposhtme:

- Të ushtrojnë profesionin e ekspertit kontabël të licensuar (audituesit ligjor) për jo më pak se 5 (pesë) vitet e fundit;
- Të mos kenë marrë masa disiplinore në fuqi;
- Të mos jenë anëtar të ndonjë partie politike në 5 (pesë) vitet e fundit;
- Të mos kenë qenë kandidat të mbështetur nga ndonjë parti politike, koalicion apo kandidat i propozuar nga zgjedhësit në 2 (dy) zgjedhjet e fundit;
- Prindërit, bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja dhe fëmijët madhor të mos jenë anëtarë të partisë politike objekt i auditimit.

Aplikantët duhet të dorëzojnë brenda datës 1.11.2024 në mënyrë elektronike në email-in [Krist.Puleri@kqz.gov.al](mailto:Krist.Puleri@kqz.gov.al) ose fizikisht pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dokumentat si më poshtë vijon:

- Kopje të noterizuar të licencës të ekspertit kontabël të licensuar (auditues ligjor), lëshuar nga IEKA, e vlefshme për vitin kalendarik respektiv;
- Vërtetim nga IEKA që vërteton se eksperti kontabël i licensuar (audituesi ligjor) ka jo më pak se 5 (pesë) vite eksperiencë dhe se nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- Fotokopje të dokumentit të identifikimit;
- Deklaratë vetjake se nuk është në kushtet e parashikuara në shkronjat “c” dhe “d” të sipërcituara, sipas formatit të miratuar në shtojcën 1 bashkëlidhur udhëzimit nr. 14, datë 9.6.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për caktimin e kriterëve, procedurat për përzgjedhjen dhe emërimin e ekspertëve kontabël të licensuar dhe kushtet kontraktuale për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga

partitë politike gjatë viti kalendarik dhe subjektet zgjedhore dhe kandidatët e tyre në fushatën zgjedhore”;

- e. Raport mjeko-ligjor;
- f. Vërtetim të gjendjes gjyqësore.

Pas përfundimit të periudhës së aplikimit, sektori përgjegjës për verifikimin e aplikantëve që dorëzojnë dokumentacionin realizon, brenda 5 (pesë) ditëve, verifikimin e plotësimit të kriterëve formale të sipërcituara. Pas verifikimit dhe përzgjedhjes së aplikantëve që plotësojnë kriteret e sipërcituara Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nxjerr njoftimin për hedhjen e shortit për përzgjedhjen e ekspertëve kontabël të licensuar (audituesit ligjorë), të cilët do të auditojnë fondet e përfituara dhe të shpenzuara nga subjektet zgjedhore dhe kandidatët e tyre për fushatën zgjedhore, të datës 4 Gusht 2024.